



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
DREJTORA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE PROGRAMEVE TË STREHIMIT

Nr. 33 prot.

Vorë, më 11. 11. 2025

NJOFTIM PUBLIK

MBI ZHVILLIMIN E TAKIMIT KONSULTUES PËR PROJEKTBUXHETIN
AFATMESËM 2026–2030

Në zbatim të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” dhe në kuadër të procesit të hartimit të Buxhetit Afatmesëm të Bashkisë Vorë për periudhën 2026–2030, Bashkia Vorë fton të gjithë qytetarët, përfaqësuesit e komunitetit, bizneset, organizatat joqeveritare dhe institucionet publike të marrin pjesë në takimin konsultues publik.

 Data: 17.11.2025

 Ora: 15:00

 Vendi: “Continental”, Vorë

Qëllimi i këtij takimi është prezantimi i prioriteteve dhe objektivave buxhetore të Bashkisë për periudhën 2026–2030, si dhe mbledhja e mendimeve, komenteve dhe sugjerimeve nga publiku për programet e zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisor të njësive administrative të bashkisë. Bashkia Vorë inkurajon pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe grupeve të interesit për të ndërtuar së bashku një buxhet transparent, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me nevojat reale të komunitetit.

Adresa: Vorë

Bashkia Vorë

Në shërbim të qytetarëve!

Adresa: Rr.”Unaza”, nr.2 - Vorë – Tiranë, KodiPostar 1032, info@bashkiavore.gov.al